

# TERMAT E REFERENCËS

## 1. Objekti i prokurimit

Objekti i kësaj procedure është furnizimi me 2 (dy) mjete teknologjike tip Reachstacker, të reja dhe të papërdorura, të destinuara për përpunimin dhe lëvizjen e kontejnerëve në terminalin e kontejnerëve të Autoritetit Portual Durres.

## 2. Qëllimi i prokurimit

Qëllimi i kësaj procedure është sigurimi i mjeteve teknologjike të përshtatshme për rritjen e kapaciteteve operacionale të terminalit të kontejnerëve, përmirësimin e efikasitetit të përpunimit të ngarkesave, garantimin e vazhdimësisë së operacioneve portuale dhe optimizimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes.

## 3. Përshkrimi i mallrave

Objekti i furnizimit përfshin furnizimin me **dy (2) mjete teknologjike tip Reachstacker**, të reja dhe të papërdorura, të destinuara për ngritjen, transportimin dhe stivimin e kontejnerëve ISO në terminalin e kontejnerëve të Autoritetit Portual Durres.

Reachstacker-ët duhet të jenë të përshtatshëm për operacione portuale me ngarkesa të rënda dhe cikle të përsëritura pune, duke garantuar siguri, stabilitet, performancë dhe besueshmëri gjatë operimit.

Pajisjet e furnizuara duhet të dorëzohen të plota, të montuara dhe të gatshme për punë, së bashku me të gjithë komponentët, sistemet, aksesoret standardë të prodhuesit dhe dokumentacionin teknik të nevojshëm për përdorimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre.

## 4. Kërkesat teknike

Reachstacker-ët e ofruar duhet të jenë **të rinj dhe të papërdorur** dhe të përmbushin kërkesat teknike, funksionale, të sigurisë, cilësisë dhe performancës të përcaktuara në Specifikimet Teknike, të cilat janë pjesë përbërëse e dokumenteve të procedurës së prokurimit.

Pajisjet duhet të jenë në përputhje me standardet dhe legjislacionin teknik të aplikueshëm, si dhe të përshtatshme për operim të vazhdueshëm në kushtet e punës së terminaleve portuale.

## 5. Shërbimet e përfshira

Përveç furnizimit të 2 (dy) Reachstacker-ëve, operatori ekonomik duhet të përfshijë në ofertë, pa kosto shtesë për Autoritetin Portual Durrës:

- transportin deri në Autoritetin Portual Durrës;
- shkarkimin, montimin (nëse nevojitet) dhe vendosjen në funksion ;
- kryerjen e të gjitha kontrolleve dhe testeve funksionale;
- dorëzimin e dokumentacionit teknik dhe dokumentacionit të garancisë;
- trajnimin teorik dhe praktik të personelit të Autoritetit Portual Durrës;
- asistencën teknike, mirëmbajtjen dhe riparimin gjatë periudhës së garancisë.

## 6. Garancia

Operatori ekonomik duhet të ofrojë një periudhë garancie minimale prej **24 (njëzet e katër) muajsh ose 4,000 (katër mijë) orësh pune, cilado që të plotësohet e para**, për të gjithë Reachstacker-in, komponentët dhe sistemet e tij, duke garantuar funksionimin normal të pajisjes dhe mbulimin e çdo defekti që lidhet me **projektimin, prodhimin, montimin, materialet e përdorura, komponentët ose funksionimin e sistemeve të pajisjes**, gjatë përdorimit në përputhje me udhëzimet dhe manualët e prodhuesit. Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik është përgjegjës për kryerjen e riparimeve, zëvendësimin e pjesëve me defekt dhe rikthimin e pajisjes në gjendje pune, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Për komponentët e mëposhtëm kërkohen periudha garancie të zgjatura:

- Punimet e bojatisjes dhe mbrojtjes kundër korrozionit: **5 (pesë) vjet**;
- Struktura dhe komponentët mbajtës të boshtit të lëvizjes: **5 (pesë) vjet**;
- Struktura e Spreader-it: **5 (pesë) vjet**;
- Struktura mbajtëse e shasisë dhe bumit (boom): **10 (dhjetë) vjet**.

Këto periudha garancie të zgjatura do të zbatohen për defektet që lidhen me projektimin, materialet, prodhimin, montimin ose integritetin strukturor të komponentëve përkatës. Garancia nuk do të mbulojë dëmtimet që vijnë si rezultat i përdorimit jo në përputhje me manualët dhe udhëzimet e prodhuesit, mbingarkesës, aksidenteve, dëmtimeve të shkaktuara nga faktorë të jashtëm ose ndërhyrjeve/riparimeve të kryera nga persona të paautorizuar.

## 7. Dokumentacioni teknik

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë, për secilin Reachstacker të furnizuar, dokumentacionin teknik origjinal në format elektronik dhe fizik. Dokumentacioni duhet të jetë në gjuhën angleze dhe duhet t'i referohet specifikisht modelit dhe konfigurimit të pajisjes së ofruar, jo dokumentacioni i përgjithshëm ose katalogë standardë.

Dokumentacioni teknik duhet të përfshijë minimalisht:

- Specifikimet teknike të plota të Reachstacker-it, përfshirë të dhënat identifikuese të pajisjes (modeli, numri serial, viti i prodhimit, të dhënat e pllakës identifikuese) dhe të komponentëve kryesorë;
- Manualin e përdorimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Reachstacker-it;
- Manualet teknike të prodhuesve OEM për montimin, çmontimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e komponentëve kryesorë, përfshirë:
  - motorin;
  - transmisionin;
  - boshtet e lëvizjes;
  - sistemin hidraulik;
  - Spreader-in dhe komponentët përkatës;
- Skemat elektrike dhe hidraulike të plota të pajisjes, duke përfshirë skemat e lidhjeve dhe komponentëve kryesorë;
- Katalogun e pjesëve të këmbimit OEM për Reachstacker-in dhe komponentët kryesorë, me numrat identifikues dhe kodet e pjesëve;
- Listën e pjesëve të instaluar dhe sasitë përkatëse për komponentët kryesorë;
- Listat e kodeve të defekteve dhe procedurat diagnostikuese për sistemet kryesore të pajisjes, përfshirë motorin, transmisionin, Spreader-in dhe njësinë elektronike të kontrollit (ECU);
- Manualin për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve (Troubleshooting Manual);
- Tabelat e mirëmbajtjes periodike, lubrifikimit dhe grasimit për të gjitha komponentët lëvizës dhe rrotullues, duke përfshirë:
  - llojet e vajrave dhe lubrifikantëve të rekomanduar nga prodhuesi;

Të gjitha manualet dhe dokumentet teknike duhet të dorëzohen së bashku me pajisjen dhe do të konsiderohen pjesë përbërëse e furnizimit.

## 8. Trajnimi

Operatori ekonomik duhet të sigurojë, pa kosto shtesë, trajnim teorik dhe praktik për operatorët dhe personelin e mirëmbajtjes të Autoritetit Portual Durrës.

Trajnimi duhet të përfshijë:

- përdorimin e sigurt të Reachstacker-it;
- karakteristikat teknike dhe parametrat e performancës;
- mirëmbajtjen periodike dhe parandaluese;
- diagnostikimin e defekteve;
- sistemet mekanike, elektrike, elektronike dhe hidraulike;
- procedurat e sigurisë dhe emergjencës.

Trajnimi praktik duhet të zhvillohet gjatë vënies në funksion të pajisjeve dhe të zgjasë jo më pak se **3 ditë pune**, me praninë e një tekniku të certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

## 9. Testimi

### 9.1 Testimi në fabrikën e prodhuesit

Përpara dorëzimit të pajisjeve, prodhuesi duhet të kryejë testimet funksionale sipas procedurave të tij të kontrollit të cilësisë (Factory Acceptance Test – FAT ose procedurë ekuivalente).

Operatori ekonomik duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendrike përpara datës së zhvillimit të këtyre testeve, me qëllim që Komisioni i Marrjes në Dorëzim ose përfaqësues të autorizuar të Autoritetit Portual Durres të kenë të drejtën të jenë të pranishëm gjatë zhvillimit të tyre.

### 9.2 Testimi pas dorëzimit

Reachstacker-at do të dorëzohen plotësisht të montuar, të testuar dhe të gatshëm për operim.

Pas dorëzimit do të kryhen prova funksionale në kushte normale pune për një periudhë minimale prej **24 orësh efektive pune**, me qëllim verifikimin e performancës së pajisjeve dhe të të gjitha sistemeve të tyre.

Autoriteti Portual Durres do të sigurojë ngarkesat e nevojshme për realizimin e provave funksionale.

Brenda 5 ditëve nga dorëzimi, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë inspektimin dhe testimin e pajisjeve nëpërmjet Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Furnizimit.

Në rast se pajisjet nuk përmbushin specifikimet teknike ose nuk kalojnë me sukses testimet funksionale, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të refuzojë marrjen në dorëzim deri në eliminimin e mangësive.

## **10. Pranimi i pajisjeve**

Pranimi i Reachstacker-ëve do të kryhet nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet Komisionit të Marrjes në Dorëzim, pas përfundimit të dorëzimit fizik të pajisjeve, verifikimit të dokumentacionit teknik dhe realizimit me sukses të provave funksionale sipas kërkesave të përcaktuara në këto Terma Reference.

Gjatë procesit të pranimit do të verifikohet:

- përputhshmëria e pajisjeve të furnizuara me specifikimet teknike dhe ofertën e operatorit ekonomik;
- marka, modeli, numrat serialë dhe të dhënat identifikuese të pajisjeve;
- kompletimi i pajisjeve me të gjithë aksesorët dhe komponentët e kërkuar;
- dorëzimi i dokumentacionit teknik të pajisjes, manualeve të përdorimit dhe mirëmbajtjes, Deklaratës së Konformitetit CE ose dokument ekuivalent, Certifikatës së Origjinës ose dokument ekuivalent, dokumentacionit të testeve dhe kontrolleve të kryera, si dhe dokumenteve të garancisë së prodhuesit për pajisjen e furnizuar;
- funksionimi normal i sistemeve mekanike, elektrike, elektronike dhe hidraulike.

Në rast se gjatë procesit të pranimit konstatohen mangësi, defekte ose mosplotësim të kërkesave teknike, Autoriteti Portual Durres ka të drejtë të kërkojë eliminimin e tyre përpara pranimit përfundimtar.

Pranimi përfundimtar do të kryhet pas përfundimit me sukses të testeve funksionale dhe plotësimit të të gjitha detyrimeve kontraktuale nga operatori ekonomik.